



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranimar / Dorezuar Primiemo/Predata Received/Received	23.06/2021	1	with 400 Voto
Organ /Bjesta Organ /Jedinstvo Org /Unit	Nr Prot to Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUPSHINA	3291/2021		1/5



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.549/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Jeton Koca dhe Eshref Shabani -anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit A.nr.916/20 të datës 08.06.2021 i protokolluar në Këshill me datën 16.06.2021 me Nr.3106/2021 kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.722/2019 të datës 20.11.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Rr"İbish Rama" fshati Qirez Komuna e Skenderajt, kundër Vendimit me Nr. 125/20 të datës 21.02.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 23.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër protokollit 722/2019 e datës 20.11.2019, e parashtruar nga ankuesi

II. Shfuqizohet Vendimi i komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave me Nr. 125/20 i datës 21.02.2020 Ministrisë së Punëve të Brendshme me të cilin anulohet procedura e rekrutimit sipas konkursit të datës 28.08.2020 të shpallur nga Ministria e Punëve të Brendshme për pozitën Zyrtar për të huaj në Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migracion - Qendra për Mbajtjen e të Huajve.

III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi, në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Ar sy e t i m

Ankuesi ka aplikuar në konkursin e datës 28.08.2019 për pozitën Zyrtar për të Huaj në Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migracion - Qendra për Mbajtjen e të Huajve. Me datën 17.01.2020 përmes njoftimit me nr.23/20 Komisioni Përzgjedhës ka rekomanduar kandidatin me 77% pikë. Kandidatja e cila kishte marrë 57.05% pikë sipas raportit përmbledhës të datës 02.10.2020 pas njoftimit të datës 17.01.2020 me datën 22.01.2020 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Punëve të Brendshme me pretendimin ankimor se njoftimi për kandidatin e përzgjedhur është bërë në kundërshtim me nenin 41 paragrafi 4 i Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me vendimin Nr.02/2020 të datës 18.02.2020 ka aprovuar ankesën e ankuses dhe ka anuluar konkursin e datës 28.08.2019 për pozitën Zyrtar për të Huaj në Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migracion - Qendra për Mbajtjen e të Huajve.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr.02/2020 të datës 18.02.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës Ministrisë së Punëve të Brendshme, më datë 30.03.2020 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokollit 698/2020.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Punëve të Brendshme, më datë 20.11.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5453/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin ankimor se procedura e rekrutimit për pozitën Zyrtar për të Huaj në Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migracion - Qendra për Mbajtjen e të Huajve është zhvilluar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil.

Në mungesë të kuorumit për vendosje në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankuesi të njëjtën kohë ka hapur edhe konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 08.06.2021 ka nxjerr Aktgjykimin me numër A.nr.916/20, përmes të cilit ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtoj dhe të vendos për ankesën A.nr.722/2019 të datës 20.11.2019 të parashtruar nga ankuesi Fehmi Rama.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 01.04.2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme. Ministria e Punëve të Brendshme me datën 08.04.2020 ka dërguar Përgjigjen në ankesë bashkë me provat e lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 698/2020 të datës 30.03.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizim i MAP/DASHC i datës 26.08.2020; Kopja e Konkursit e

datës 28.08.2020; Vendimi për Themelimin e Komisionit Përzgjedhës të datës 16.09.2019 me nr.638/19; Form.MAP-SHCK-07a; Form.MAP-SHCK-05 - Përcaktimi i kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë; Regjistri i aplikacioneve të listës së gjërë; Lista e ngushtë e datës 18.09.2019; Lista e ngushtë e aplikantëve për testin me shkrim e datës 26.09.2019; Kopja e testit me shkrim e datës 26.09.2019; Lista e aplikantëve sipas pikëve të fituara nga Testi me shkrim i datës 27.09.2019; Lista e aplikantëve për intervistën me gojë e datës 01.10.2019; Përmbledhja e vlerësimeve individuale e datës 02.10.2019; Raporti përmbledhës i datës 02.10.2019; Raporti final i rekomandimit nga komisioni Rekrutues i datës 02.10.2019; Njoftimi i datës 17.01.2020 me nr.23/20 për kandidatin e suksesshëm; Njoftim i datës 02.03.2020 me nr.170/20 për anulimin e konkursit; Vendimi me nr.151 i datës 28.02.2020 për anulimin e konkursit; Vendimi me nr.02/2020 i datës 21.02.2020; Kërkesa për punësim e datës 04.09.2020 për bashkë me dokumentacionin e kërkuar dhe Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 14.04.2020 bashkë me provat e lëndës faqe 1/192.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se kandidati i përzgjedhur në bazë të dokumentacionit që posedon ka plotësuar kushtet për përzgjedhjen në pozitën Zyrtar për të Huaj në Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migracion - Qendra për Mbajtjen e të Huajve, ndërkaq procedura e rekrutimit ka qenë në rregull.

Me datë 22.01.2020 znj.M.L në cilësinë e aplikantes ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Punëve të Brendshme kundër njoftimit të datës 02.10.2019 i cili është publikuar me datën 07.01.2020 për kandidatin e përzgjedhur me pretendimin ankimor se procedura e rekrutimit për pozitën Zyrtar për të Huaj në Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migracion - Qendra për Mbajtjen e të Huajve, është zhvilluar në kundërshtim me nenin 41 paragrafi 4 i të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, sipas të cilit: *"Rezultatet publikohen brenda 7 ditëve pas përfundimit të procedurës së rekrutimit dhe vendimit për emërimin e kandidatëve të suksesshëm, edhe pse raporti përfundimtar për rekomandim është përfunduar në afat dhe kohë të rregullt"*, edhe pse raporti përfundimtar për rekomandim është përfunduar në afat dhe kohë të rregullt".

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Punëve të Brendshme me datën 21.02.2020 ka nxjerrë vendimin me nr.125/20 me të cilin ka aprovuar ankesën e ankueses dhe ka anuluar konkursin e datës 28.08.2019, duke obliguar Divizionin e Burimeve njerëzore që të zbatojë vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave.

Organi i punësimit në këtë rast Ministria e Punëve të Brendshme në përgjigjen e datës 27.11.2019 në përgjigjen në ankesë lidhur me ankesën e ankuesit kanë deklaruar se : njoftimi për kandidatin e suksesshëm për pozitën Zyrtar për të Huaj në Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migracion - Qendra për Mbajtjen e të Huajve, nuk është publikuar në web faqen e MPB-së për shkak të dilemave që Ministria e Administratës Publike si Ministri përgjegjëse për administratë publike nuk ka dhënë sqarime me shkrim pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se e gjithë procedura e rekrutimit për pozitën "Zyrtar për të Huaj në Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migracion - Qendra për Mbajtjen e të Huajve" është zhvilluar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Punëve të Brendshme, me rastin e nxjerrjes së vendimit të datës 21.02.2020 me nr. Protokolli 125/20, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi.

Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.549/2021, datë 23/06/2021

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse

Arben MEHMETI

Arben Mehmeti
Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së



[Handwritten mark]